



UDHËZUES PËR PRINDËRIT MBI SIGURINË ONLINE TË FËMIJËVE DHE TË RINJVE





Rëndësia e internetit të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë

Dinamikat e të jetuarit kanë ndryshuar ndjeshëm si rezultat i zhvillimit të teknologjisë me ritme të shpejta. Fëmijët dhe të rinjtë shpenzojnë shumë kohë në internet dhe kjo shoqërohet me frikëra dhe dilema në lidhje me çfarë duhet të dinë dhe si duhet të veprojnë dhe nxiten fëmijët të lundrojnë të sigurt online.





Të kuptojmë rreziqet online



Phishing

Phishing ndodh kur një person dërgon një tekst të rremë, email ose mesazh pop-up për t'i bërë njerëzit të ndajnë informacionin e tyre personal, fjalëkalimet ose informacionin financiar. Pasi të kenë këtë informacion, këta sulmues përdorin informacionin e mbledhur për të kryer vjedhje identiteti ose për të vjedhur para.



Grooming

Është veprimtaria e vendosjes së kontaktit / fillimit të një marrëdhënie me një fëmijë, personalisht apo me anë të përdorimit të internetit ose teknologjive të tjera digjitale, për të mundësuar ndërveprimin seksual me fëmijën. Ndërveprimi seksual mund të ndodhë online ose në jetën e përditshme.



Bullizmi Kibernetik

Bullizmi kibernetik te fëmijët ndodh kur dikush përdor mediat sociale për komunikimin apo shpërndarjen e përmbajtjeve të ndryshme (mesazhe, foto) me qëllim ngacmimin, poshtërimin, turpërimin apo kërcënimin e fëmijëve ose personave nën 18 vjeç.



✘ Sexting

Sexting quhet shkëmbimi i mesazheve apo imazheve seksuale, të cilat përmbajnë pamje të zhveshura apo gati të zhveshura nëpërmjet telefonisë celulare dhe/ose internetit, mediave sociale ose aplikacioneve të ndryshme, midis një të rrituri dhe një fëmije.

✘ Gjuha e dhunshme online

Gjuha e urrejtjes mbulon të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë. Kjo përfshin intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv apo nga diskriminimi dhe armiqësia kundër pakicave, emigrantëve etj.

✘ Radikalizmi online

Radikalizimi online është aksesimi ose ekspozimi ndaj materialeve ekstremiste në internet nëpërmjet mediave sociale ose platformave të tjera online - për shembull propaganda duke përfshirë fotografi, video, blogje dhe lajme të rreme, ekspozimi ndaj aktiviteteve ekstremiste, terroriste etj.


✘ Trafikimi i qenieve njerëzore

Trafikimi online i qenieve njerëzore përfshin përdorimin e internetit dhe teknologjive digjitale për të rekrutuar, shfrytëzuar dhe kontrolluar individët në forma të ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore.



Pasoja që mund të ketë një fëmijë apo i ri i ekspozuar ndaj një rreziku online:


- Shqetësime të gjumit dhe ankth.
- Probleme të shëndetit mendor. Ndihen të izoluar, turpëruar, zemëruar dhe pa dëshirë.
- Vetvlerësim i ulët për veten.
- Ndryshime në sjellje. Braktisje e shkollës ose e grupeve shoqërore.
- Frikë për jetën. Ndihen të kërcënuar.
- Dëmtim të vetes deri në vetvrasje.





Si t'i ndërgjegjësoni fëmijët tuaj që të jenë të kujdesshëm ndaj rreziqeve online

- Krijoni një mjedis ku mbizotëron dashuria dhe ngrohtësia në familjen tuaj.
- Flisni me fëmijët rreth abuzimit seksual.
- Flisni me fëmijët rreth trafikimit dhe trafikimit online.
- Flisni me fëmijët për rrezikun e mediave sociale.
- Kushtojini vëmendje fëmijëve, mos i lini pas dore ata.





Disa këshilla teknike për ju prindër në lidhje me sigurinë online të fëmijëve dhe të rinjve



- Sigurohuni që faqet e internetit që ju apo fëmijët tuaj përdorin të jenë të sigurta
- Ruani informacionin personal
- Mësojini fëmijët të përdorin mjete bllokimi dhe raportimi
- Mësojini fëmijët tuaj të raportojnë të gjitha aktivitetet e dyshimta



Ku mund të raportoni kërcënimet apo ngacmimet online?

- Raportoni rastin në faqen e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kiberntike: <https://cesk.gov.al/raporto-3/>
- Raportoni në Linjën Kombëtare të Ndhmës për Fëmijët në Shqipëri - ALO 116 111
- Kontaktoni mësuesin apo psikologun e shkollës.
- Kontaktoni me punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkisë suaj

